



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:251759

Datë: 24.04.2024

Numri i dokumentit: 05613489

C-IV.-14-5437

Ankuesi:

D I, Gjilan.

Përfaqësuar nga **Av. M F N**, Gjilan.

Kundër:

N.SH. “Drita”,

përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, lagja Lakrishtë rruga “Dritan Hoxha” nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), me gjyqtaren Ganimete Puka, me datë 24 prill 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET** ankesa si e pabazuar dhe **VËRTETOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit nr. GJI077-0020 i datës 06 qershor 2014, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.
- II. **Secila palë i bart shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 17 korrik 2014, ankuesi parashtrij ankesë - kërkesë për rishqyrtimin e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit nr. GJI077-0020 të datës 06 qershor 2014, me të cilin i ishte refuzuar kërkesa për kompensim për paga të papaguara në shumën prej 12,600.00 € nga N.SH “Drita”, (në likuidim) për periudhën prej vitit 2000 deri më 2006. Ankuesi pohoi se, vendimi kundër të cilit ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim është për shkak të aplikimit të gabuar të se drejtës materiale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Ankuesi i propozon Gjykatës, që ankesën e tij ta aprovoj si të bazuar.

Ankuesi ka bashkangjitur si provë: kopjen e vendimit të kundërshtuar, kalkulimin e pagave prej 01.01.2000 deri me 31.12.2006, letër konfirmimi i datës 18.04.2024 si dhe njoftimi për të gjithë kreditorët dhe pronarët e ndërmarrjes.

Me 29 mars 2024, e paditura AKP-ja parashtrroi mbrojtje, në të cilën pohoi se AL ka bërë vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. E paditura pohoi se ankuesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit 04/L-034 është shkelur nga AL në marrjen e vendimit. Po ashtu e paditura pohoi se kërkesa e ankuesit është e parashkruar në pajtim me nenin 36.2 të Shtojcës së Ligjit 04/L-034. Më tej e paditura pohoi se një kërkesë monetare e çfarëdo lloji që një punëtor mund të ketë ndaj një punëdhënësi duhet të jetë paraqitur para ndonjë gjykate apo organi tjetër kompetent brenda periudhës tre vjeçare nga momenti kur N.SH-ja supozohet të mos i ketë përmbushur detyrimet e saj monetare ndaj parashtruesit. E paditura propozoi që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i AL-së.

Në lidhje me detajet tjera, gjykata i referohet shkresave të lëndës dhe parashtrësive të palëve.

Arsyetimi ligjor

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se *“pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësia apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese)”*, ndërsa pika 3 parasheh se *“pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë”*.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Në këtë rast gjykata gjen se nuk është kontestues fakti se ankuesi ka qenë punëtorë i NSH-së, por kontestues ka qenë fakti nëse NSH i ka mbetur borxh pagat e pa paguara në shumën e kërkuar nga ankuesi.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe ka ndërmarr veprimet e nevojshme procedurale, ashtu që konstaton si në vijim.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi ishte një punëtor i N.SH. Në këtë çështje, kontestuese ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës së ankuesit dhe mungesa e të provuarit me prova me të cilat do dëshmohej se N.SH. i ka mbetur borxh ankuesit pagat e papaguara nga viti 2000 deri në janar 2006, në shumë prej 12.600.00 €. E paditura e ka kundërshtuar kërkesën e ankuesit duke pretenduar se e njëjta është parashkruar, me arsyetim se ankuesi nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndërprerjes së këtij afati. Ankuesi e ka kundërshtuar një pretendim të tillë si të pa drejtë dhe jo të saktë, sepse AL ishte dashtë të merre parasysh periudhe tri vjeçar dhe pjesërisht të aprovohen për pagat e pa paguar për periudhën 1 janar.2004 deri me 27.dhjetor 2007, dhe t'ia paguar shumën prej 5.700.00 €, dhe se në rastin konkret konsideron se nuk ka pasur parashkrim të kërkesës.

Gjykata vlerëson se nuk është e mjaftueshëm vetëm pretendimi i ngritur nga palët për çështjen e parashkrimit sepse në këtë lëndë e paditura e ka kontestuar edhe mungesën e të provuarit me prova duke u thirrur në neni 7 të LPK-së dhe në Ligjin për Dhomën e Posaçme, ndërsa ankuesi nuk ka bashkangjitur prova relevante me të cilat do dëshmohej se N.SH. , i ka mbetur borxh ankuesit pagat e papaguara nga viti 2000 deri në dhjetor 2006, në shumë prej 12,600.00 €.

Ankuesi edhe me ankesë para gjykatës nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon se N.SH. i ka mbetur borxh pagat e papaguara në shumë prej 12,600.00 €. Kopja e vendimit të atakuar të Autoritetit të Likuidimit, kalkulimi i pagave personalisht nga ankuesi, dt 22.10.2013, letër konfirmimi AKP, dt 18.prill.2024, formula kur NSH ka hy në privatizim dt.28.12.2008, nuk janë dëshmi me të cilat dëshmohet e N.Sh i ka mbetur borxh ankuesit. Përfundimish ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon se NSH “Drita”, nuk i ka bërë pagesën në të cilën kërkon kompensim për paga të papaguara në shumën prej 12,600.00 € për kohë të pacaktuar. Ankuesi, ka dështuar që të dorëzojë prova relevante në mbështetje të ankesës së tij, dhe ankesa u refuzua.

Ankuesi edhe me përgjigjen ndaj mbrojtjes së të paditurës, ka dështuar që të dorëzojë prova relevantë me të cilat do të dëshmohej se N.SH i ka mbetur borxh pagat e papaguara në shumë e pretenduar, andaj Gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për paga të pa paguara, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Andaj në bazë të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54 par.1 dhe 74 par.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimimit.

Gjykata nga shkresat e lëndës vjen në përfundim se ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon se NSH “Drita”, nuk i ka bërë pagesën në të cilën kërkon kompensim për paga të papaguara në shumën prej 12,600.00 € për kohë të pacaktuar. Ankuesi, ka dështuar që të dorëzojë prova relevante në mbështetje të ankesës së tij. Kopja e vendimit të atakuar të Autoritetit të Likuidimit dhe provat tjera të cekura më lartë nuk dëshmojnë se N.SH nuk i ka paguar ankuesit kompensimin e kërkuara në afat të kërkuar.

Ankuesi ka dështuar që të dorëzojë prova në mbështetje të ankesës së tij. Gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për paga të pa paguara, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Përfundimisht gjykata ka ardhur në përfundimin se në rastin konkret vendimi i atakuar, nga pala kundërshtarë është i drejtë kur ka vepruar dhe ka zbatuar drejtë dispozitën ligjore të cituar me lartë dhe gjykata bazuar në vërtetimin e kësaj gjendje faktike dhe në pajtim me dispozitën e nenit 54.1 lidhur me nenin 74 të Ligjit nr. 06/L- 086 për Dhomën e Posaçme në çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Privatizimit , vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do të mbulojë shpenzimet e veta. Në pajtim me nenin 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, ankuesi ka paguar taksës gjyqësore .

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

G j y q t a r e

Ganimete Puka